

VENDIM
Nr. 368, datë 6.5.2020

PËR SHEMBJEN E TRE OBJEKTEVE TË DHËNA ME QIRA ME KONTRATËN E QIRASË NR.2604 REP., NR. 727 KOL., DATË 14.10.2019, ME TARIFËN 1/EURO KONTRATA, NDRYSHUAR ME ANEKSKONTRATËN NR. 479 REP., NR. 189 KOL., DATË 28.2.2020, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCIVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “MTSC”, SH.P.K., SI QIRAMARRËS, NË ADMINISTRIM TË NDËRMARRJES INDUSTRIALE NR.1, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe të pikës 7, kreut VIII, të vendimit nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shembjen e tre objekteve me emërtimet “Objekti nr.1” 2 kat, “Objekti nr.2” 1 kat, “Objekti nr.3” 1 kat, me sipërfaqe totale ndërtimore 2497.04 m², të dhëna me qira me kontratën e qirasë nr.2604 rep., nr.727 kol., datë 14.10.2019, me tarifën 1/euro kontrata, ndryshuar me anekskontratën nr.479 rep., nr.189 kol., datë 28.2.2020, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë “MTSC”, sh.p.k., si qiramarrës, miratuar me vendimet e Këshillit të Ministrave, nr.642, datë 2.10.2019 dhe nr.157, datë 19.2.2020, për pronën nr.19, me emërtim “Ish-Ndërmarrje Metalike “Tirana”” (Reparti i Orëve), me nr.pasurie 7/649, me sipërfaqe të përgjithshme të marrë me qira 4894.10 m², prej nga sipërfaqe totale e truallit 4021.50 m², nga të cilat sipërfaqe funksionale 2397.06 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 2497.04 m², zona kadastrale 8220, në administrim të Ndërmarrjes Industriale nr.1, Tiranë, sipas tabelës nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ndërmarrja Industriale nr.1 Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela NR 1

Ndërtesa në administrim të Ndërmarrjes Industriale nr.1, që miratohet për ndërrjen nga përdorimi, me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. _____, datë _____, 2020

| Nr | Njësia që e administron | Nr.pronës/ Vendodhja | Emërtimi I ndërtesës | Sipërfaqja (m2) |
|----|-----------------------------|---|-----------------------|-----------------|
| 1 | Ndërmarrja Industriale nr.1 | Prona nr.19, "Ish ndërmarrja metalike Tiranë (Reparti I Orëve)" | Objekti nr.1 - kati 0 | 872.6 |
| 2 | Ndërmarrja Industriale nr.1 | Prona nr.19, "Ish ndërmarrja metalike Tiranë (Reparti I Orëve)" | Objekti nr.1 - kati 1 | 872.6 |
| 3 | Ndërmarrja Industriale nr.1 | Prona nr.19, "Ish ndërmarrja metalike Tiranë (Reparti I Orëve)" | Objekti nr.2 | 420.44 |
| 4 | Ndërmarrja Industriale nr.1 | Prona nr.19, "Ish ndërmarrja metalike Tiranë (Reparti I Orëve)" | Objekti nr.3 | 331.4 |